

# **RAPORT NGA KRYESUESI I CEFTAs**

**Janar - Dhjetor 2018**

## **QËLLIMI I RAPORTIT**

Qëllimi i këtij dokumenti është raportimi mbi aktivitetet dhe takimet që janë mbajtur gjatë periudhës janar - dhjetor të vitit 2018 dhe të cilat nuk bien drejtpërdrejtë në fushëveprimin e Komitetit për Lehtësimin e Tregtisë dhe Komitetit për Pikat e Kontaktit dhe Nën-komiteteve të CEFTA-s.

### **1. VIZITA STUDIMORE**

Gjatë periudhës raportuese, është organizuar një vizitë studimore në Bruksel me qëllim të lehtësimit të përgatitjes së Programeve vjetore të Punës në fushat përkatëse. Në këtë vizitë studimore, më datën 23-24 janar të vitit 2018 janë organizuar një sërë takimesh me Sekretariatit e CEFTA-s dhe me DG (Drejtori të Përgjithshme) relevant të linjës në Komisionin Evropian.

### **2. NGJARJA INFORMUESE PËR PRIORITETET E KRYESIMIT TË CEFTA-s TË VITIT 2018**

Më datën 24 janar të vitit 2018, kryesuesi i radhës i CEFTA-s organizoi një ngjarje publike për të paraqitur prioritetet e kryesimit të CEFTA-s gjatë vitit 2018 tek mjedisi ndërkombëtar me qendër në Bruksel. Kjo ngjarje është bashkë-organizuar nga Sekretariati i CEFTA-s. Kryesuesi i radhës së CEFTA-s dhe Komisioni Evropian së bashku me Sekretariatit e CEFTA-s kanë prezantuar perspektivat e tyre në lidhje me CEFTA-n. Në kuadër të vizitës studimore, Sekretariati i CEFTA-s organizoi një takim për kryesuesit e CEFTA-s me përfaqësuesit e Komisionit Evropian gjatë të cilit ishin të pranishëm të gjithë Drejtoritë e Përgjithshme përkatëse (DG TRADE, TAXUD, GROWTH, TAIEX) së bashku me DG NEAR. Kështu, gjatë takimit me Komisionin Evropian, kryesuesit e CEFTA-s paraqitën prioritetet e programeve të tyre të punës.

### **3. RATIFIKIMI I PROTOKOLLIT SHITESË 5**

Protokolli Shtesë 5 (AP 5) është ratifikuar nga Shqipëria më datë 5 prill 2018, nga Bosnja dhe Hercegovina më 27 prill 2018, nga Mali i Zi më 26 dhjetor 2017, nga Maqedonia më 15 janar 2018 dhe nga Moldavia në fillim të dhjetorit të vitit 2017. Sipas Protokollit 5 të CEFTA-s, nenit 35 paragrafit 35.2 protokollin hyn në fuqi 30 ditë pas depozitimit të instrumentit të tretë. Shqipëria si depozitues në detyrë ka konfirmuar se ka pranuar 3 instrumente të ratifikimit. Instrumenti i tretë i ratifikimit ka qenë instrumenti i Malit të Zi më datën 19 mars 2018. Shqipëria si depozitues në detyrë ka njoftuar të gjitha palët e CEFTA-s se data e hyrjes në fuqi e AP 5 është data 18 prill 2018. Instrumenti i ratifikimit i BH është depozituar në Ambasadën e Shqipërisë në Zagreb më datë 24 maj 2018. Deri në dhjetor të vitit 2018, AP 5 është ratifikuar nga gjashtë palë.

#### **4. PROTOKOLLI SHITESË 6**

Në takimin e 14-të të Komitetit për Pikat e Kontaktit që u mbajt me 8 nëntor në Vjenë është arritur marrëveshja preliminare për Protokollin Shtesë 6. Kësisoj ky protokoll pritet të miratohet deri në Samitin që pritet të mbahet në Poznan në qershor të vitit 2019.

#### **5. NEGOCIATAT PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE**

Negociatat janë iniciuar në bazë të konkluzionit të takimit Special të Komitetit të Përbashkët i cili është miratuar në Prishtinë në datën 27 prill 2018 i cili thotë: "NE pranojmë rëndësinë e diskutimeve ndërmjet palëve të CEFTA-s lidhur me instrumentet më të mira të mundshme për të forcuar zbatimin e rregullave të CEFTA-s përmes mekanizmave më efektiv për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Palët e CEFTA-s kanë rënë dakord për të filluar negociatat mbi mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve tregtare, që deri më tani referohet si Protokollin Shtesë mbi Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të CEFTA-s<sup>1</sup>. Gjithashtu, gjatë negociatave do të merren parasysh analizat dhe opinionet ligjore të ofruara nga Sekretariati i CEFTA-s". Hulumtimi është realizuar nën patronazhin e Komitetit të Pikave të Kontaktit të CEFTA-s më 16 maj në Tiranë. Gjithashtu, është përgatitur drafti i Protokollit Shtesë dhe do t'i nënshtrohet procedurave të brendshme për emërimin e ekipeve zyrtare të negocimit. Palët kanë filluar procedurat e brendshme ku aktualisht 4 palë kanë miratuar tekstin dhe kanë emëruar negociatorët. Kosova\* është në favor të negocimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pa e kufizuar fushëveprimin e protokollit shtesë.

#### **6. PROGRAMI I EKSPERTËVE KOMBËTAR**

Zbatimi i programit të ekspertëve kombëtar të CEFTA-s është pezulluar për periudhën janar - prill të vitit 2018 për shkak të pengesave financiare dhe procedurale. Meqenëse periudha e KE-së për zbatimin e programit të sekretariatit për periudhën 2015-2017 i cili mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian - programi IPA me shumë-përfitues, është zgjedhur deri më datën 30 prill, sekretariati ka rifilluar realizimin e aktiviteteve përkatëse nën përgjegjësi të tij në përputhje me rregulloret përkatëse të Komisionit Evropian.

Për programin afatmesëm, pas përfundimit të përzgjedhjeve të brendshme dhe procedurave të kërkuara, Bosnja dhe Hercegovina delegoi ekspertin e tyre kombëtar për aktivitetet e SC në bujqësi dhe SPS në sekretariatit të CEFTA-s në Bruksel për periudhën nga 18 qershori deri më 31 dhjetor të vitit 2018. Kosova\*<sup>2</sup> ka dërguar të deleguarit e saj më datën 28 qershor, ndërsa Shqipëria ka dërguar të deleguarit e saj më datën 28 gusht të vitit 2018.

---

<sup>1</sup> Në korniza të ndryshme të tilla si marrëveshja e CEFTA-s dhe planit shumë-vjeçar të veprimit të ZER-së

<sup>2</sup> \*Ky emërim bëhet pa rënë ndesh me pozitën në status dhe është në përputhje me rezolutën 1244 të KS-së së OKB-së dhe opinionin e GjND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës

## **7. Grupi i përbashkët punues i CEFTA-KIEJ për politikën dhe promovimin e investimeve dhe komitetin për investime në EJ**

Duke pasur parasysh rëndësinë e agjendës së reformës së investimeve që synon të çojë në një harmonizim më të madh të politikave rajonale të investimeve në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare si dhe duke marrë parasysh potencialin e saj të rëndësishëm për nxitjen e integritit ekonomik rajonal dhe kontributin në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në ekonominë e CEFTA-s, palët e CEFTA-s kanë marrë pjesë në mënyrë aktive gjatë punës së grupit të përbashkët punues të CEFTA-KIEJ për politika dhe promovim të investimeve dhe Komiteti për Investime në EJL me objektivin për të kontribuar në zbatimin e komponentit të investimeve të PSHV-së. Kryesuesi ka siguruar përfshirjen e Pikave të Kontaktit të CEFTA-s në takimet e Grupit të Përbashkët Punues (GPP). Gjithashtu, RIRA është miratuar më datën 12 qershor 2018 dhe takimi i fundit me GPP-në është mbajtur më datë 12 dhjetor 2018.

### **1. TAKIMET E KOORDINATORËVE TË MAP PËR TREGTI MBI AGJENDËN E KONSOLIDUAR DHE PLANIN E VEPRIMIT TË CEFTA**

Më 12 mars 2018, në Bruksel, u mbajt takimi i parë i pikave të kontaktit të MAP për Komponentin e Tregtisë. Pjesëmarrësit u njohën me draft metodologjinë për monitorimin dhe raportimin e MAP/REA, të dhënat që duhet përdorur dhe treguesit për të matur ndikimin. Rezultatet e Samitit të Sofjes më 17 maj janë dakorduar dhe mënyra se si do të ndikojë secili rezultat në objektivat e MAP/REA.

Më 15 maj 2018, u mbajt takimi i dytë i pikave të kontaktit të MAP për Komponentin e Tregtisë. Takimi shërbeu si përgatitje për rezultatet e Samitit të Sofjes. U diskutua për skemën e raportimit vjetor e cila thekson zhvillimet kryesore në të gjitha komponentët e MAP/REA. Duke pasur parasysh të gjitha paralajmërimet dhe sfidat në përgatitjen e raportit, CEFTA u angazhua për të dhënë komente të konsoliduara mbi komponentin e tregtisë së REA, me qëllim që të sigurojë paraqitjen e saktë të progresit nga të dy perspektivat, kombëtare dhe rajonale.

Nuk u mbajtën më mbledhje të Koordinatorëve të Komponentëve të MAP, por takimi i Koordinatorëve të MAP që u mbajt në tetor të vitit 2018, ka ofruar Prioritetet për Shtyllën e Tregtisë të MAP që do të realizohen deri në Samitin e Poznanit dhe këto janë konfirmuar në Mbledhjen e SHERPAS në nëntor të vitit 2018.

### **2. FORCIMI INSTITUCIONAL I SEKRETARIATIT TË CEFTA**

Me qëllim të sigurimit të funksionimit të vazhdueshëm dhe efikas të Sekretariatit, si dhe zbatimit të plotë të Marrëveshjes dhe Protokolleve Shtesë të Marrëveshjes, përfshirjes në monitorimin e Shtyllës së Rritjes së Integruar të Strategjisë së EJL-së 2020 dhe Planit Shumëvjeçar të Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale nga data 12 korrik 2017, Palët e CEFTA kanë miratuar Vendimin nr. 1/2018 për të siguruar forcimin institucional të Sekretariatit të CEFTA, d.m.th. funksionet, buxhetin dhe strukturën. Procedura e re e përcaktuar në Vendimin

Nr. 2/2018 për përzgjedhjen e pjesës tjetër të stafit përveç Drejtorit është modifikuar me qëllim që të ketë një mënyrë më të thjeshtë dhe efikase. Të dyja vendimet janë miratuar në Komitetin e Përbashkët Special të CEFTA në Prishtinë më 27 prill 2018. Këto dy vendime u miratuan nga të gjitha palët e CEFTA në prani të përfaqësuesve të tyre më 27 prill 2018 dhe Vendimi hyri në fuqi më 4 gusht kur Bosnja dhe Hercegovina depozitoi komunikimin me shkrim (njoftimin) me të cilin Bosnja dhe Hercegovina i konfirmon ushtruesit të detyrës së Depozituesit, që kërkesat e brendshme ligjore për miratimin e këtij vendimi janë plotësuar. Konkursi për katër pozitë e para është publikuar dhe intervistat do të mbahen në gjysmën e parë të muajit janar të vitit 2019. Pritet që të organizohet një KPS në fillim të vitit 2019, në mënyrë që të konfirmohen rezultatet e Komitetit të Përzgjedhjes.

Duhet të theksohet se Kryesuesi i CEFTAs ka qenë i angazhuar në mbështetjen e Sekretariatit në periudhën qershor-dhjetor 2018, pasi kontratat e stafit të Sekretariatit kanë skaduar, ndërsa stafi i ri ende nuk është rekrutuar. Niveli i njëjtë i angazhimit do të pritët nga Kryesuesi për vitin 2019 pasi procedura e rekrutimit do të zgjasë deri në shkurt të vitit 2019.

#### **KALENDARI I NGJARJEVE**

Kalendari i vitit 2018 është si më poshtë:

<b>TAKIMI/NGJARJA</b>	<b>DATA</b>	<b>VENDI</b>
Takimi Ad-hoc i Ekspertëve të Origjinës të Palëve të CEFTA	8 shkurt	Bruksel
Eksperti Ad-hoc i grupit punues për Sistemin TRACES	20 shkurt	Bruksel
Takimi i 10-të i Komitetit të Pikave të Kontaktit	27-28 shkurt	Prishtinë
Takimi i 1-rë i PSHV CCP	13 mars	Bruksel
Takimi i 11-të i Komitetit të Pikave të Kontaktit	14 mars	Bruksel
Takimi rajonal i nivelit të lartë i agjencive SSF të CEFTA	18 prill	Prishtinë
Takimi i 5-të i Komitetit për Lehtësimin e Tregtisë	26 prill 2018	Prishtinë
Takimi i Grupit Punues të CEFTA-RCC-ERISEE mbi Njohjen e Kualifikimeve Profesionale	7 maj	Sarajevë
Takimi i 2-të i PSHV CCP	15 maj	Tiranë
Takimi i 12-të i Komitetit të Pikave të Kontaktit	17 maj	Tiranë
Takimi i 14-të i Nën-komitetit për Doganën dhe Rregullat e Origjinës	19 qershor	Tiranë

Takimi i 3-të i Nën-komitetit të CEFTA për Tregti në Shërbime	20 qershor	Prishtinë
Takimi i 13-të i Komitetit të Pikave të Kontaktit	21 qershor	Prishtinë
Takimi i Zëvendësministrave të CEFTA	22 qershor	Prishtinë
Punëtorja e 1-rë e LSEE CEFTA	29-30 qershor	Beograd
Diskutime eksploruese mbi Konkurrencën dhe Ndhimën Shtetërore	17-18 korrik	Shkup
Grupi i ekspertëve ad-hoc për shkëmbimin elektronik të të dhënave	5 shtator	Sarajevë
Takimi Rajonal për Validim	11 shtator	Prishtinë
Nën-Komiteti për Bujqësi dhe SSF	4 tetor	Sarajevë
Takimi i 1-rë i Ekipeve Negociuese për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale	9 tetor	Bruksel
Grupi i 2-të i punës për masat teknike	18 tetor	Prishtinë
Takimi i 2-të i grupeve punuese për menaxhimin e rrezikut dhe shkëmbimin elektronik të informacionit	19 tetor	Prishtinë
Takimi i Parë Rajonal i KKLTV-ve të CEFTA	6-7 nëntor	Vjenë
Takimi i 14-të i Komitetit të Pikave të Kontaktit	8 nëntor	Vjenë
Takimi i 15-të i Nën-komitetit për Doganën dhe Rregullat e Origjinës	13 nëntor	Tiranë
Nën-Komiteti për MJT-të	20 nëntor	Prishtinë
Takimi i Grupit Punues të CEFTA mbi Statistikat e Tregtisë në Shërbime, statistikat e FATS dhe IHD	21 nëntor	Prishtinë
Takimi i 4-të i Nën-komitetit të CEFTA për Tregti në Shërbime	21 nëntor	Prishtinë
Takimi i 6-të i Komitetit për Lehtësimin e Tregtisë	26 nëntor	Prishtinë
Takimi i 15-të i Komitetit të Pikave të Kontaktit	5 dhjetor	Prishtinë
Takimi i 13-të i Komitetit të Përbashkët	6 dhjetor	Prishtinë